QAINT
Quality, Accountability, Integrity and Transparency in Higher Education

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

PRISHTINË, JANAR 2022

# INTEGRITETI AKADEMIK, PUBLIKIMI SHKENCOR DHE JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË NË UNIVERSITETIN E SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ



UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ

# INTEGRITETI AKADEMIK, PUBLIKIMI SHKENCOR DHE JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË NË UNIVERSITETIN E SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ

Prishtinë, Janar 2022

**Publikues:**
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
www.orca-ks.org
info@orca-ks.org
Henrik Bariç, Nr. 6
Prishtina, 10000, Kosova

**Autor:**
Adea Kondirolli

**Hulumtues:**
Ilir Konushevci

**Dizajn dhe Layout:**
Envinion

Prishtinë, Janar 2022



“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë. Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një ndjenë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu! Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e shtypit. Ashtu qoftë!”

[Faik Konica]

# PËRMBAJTJA


DEFINIME ..... 7

HYRJE ..... 8

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË UNIVERSITETIT ..... 10

- Buxheti ..... 10
- Studentët ..... 10
- Transparenca formale ..... 11

PASQYRA AKADEMIKE E UNIVERSITETIT TË SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ ..... 12

- Numri i publikimeve shkencore në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj ..... 12
- Publikimi në revista të dyshimta ..... 18
- Justifikimi i titujve akademikë ..... 21

KRAHASIMI ME UNIVERSITETET E TJERA PUBLIKE ..... 24

FAKULTETI I ARKITEKTURËS, DIZAJNIT, DHE TEKNOLOGJISË SË DRURIT ..... 26

- Publikimi shkencor ..... 26
- Justifikimi i titujve akademikë ..... 27

FAKULTETI I INXHINIERISË DHE INFORMATIKËS ..... 28

- Publikimi Shkencor ..... 28
- Justifikimi i titujve akademikë ..... 29

FAKULTETI I MENAXHIMIT ..... 30

- Publikimi shkencor ..... 30
- Justifikimi i titujve akademikë ..... 31

FAKULTETI I TURIZMIT DHE AMBIENTIT ..... 32

- Publikimi Shkencor ..... 32
- Justifikimi i titujve akademikë ..... 33

METODOLOGJIA ..... 34

- Baza ligjore ..... 34
- Objekti i shqyrtimit ..... 35
- Periudha e mbledhjes së materialit për hulumtim ..... 35
- Llogaritja e justifikimit të titujve akademik ..... 36
- Llogaritja e numrit të publikimeve shkencore ..... 37

# DEFINIME

- **Punime të vlefshme për avancim –** konsiderohen punimet e publikuara në revista siç është përcaktuar me ligjet dhe rregullativat për emërim, riemërim dhe avancim të stafit akademik.

- **Punime shkencore –** punimet ku profesorët marrin pjesë si autorë pavarësisht renditjes, pra jo vetëm si autor i parë apo korrespondent.

- **Punime në revista të dyshimta –** punimet të cilat janë në revista apo në botues të listuar në listën Beall.

- **Justifikimi i titullit –** të pasurit e numrit të nevojshëm të publikimeve shkencore për titullin përkatës sipas ligjeve dhe rregullativave në fuqi.

- **Burra dhe gra –** Gjinia e presupozuar e personave në bazë të emrit pa paragjykuar identifikimin e tyre personal.

# HYRJE

Hulumtimi mbi integritetin akademik dhe publikimin shkencor në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj shënon fundin e ciklit të parë të hulumtimeve mbi integritetin akademik dhe publikimin shkencor në të gjitha universitetet publike, në kuadër të projektit QAINT.

Arsyeja pse ORCA ka hulumtuar të gjitha universitetet publike është për shkak se publiku duhet të jetë i informuar rreth cilësisë së arsimit në universitete publike, të cilat kryesisht financohen nga taksapaguesit. Vlerësimi i cilësisë së arsimit në universitete publike dhe rritja e transparencës përmes presionit publik, sipas ORCA-s ndikon në përmirësimin e cilësisë së arsimit të ofruar në këto institucione.

Hulumtimi mbi Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) ishte sfidues në vetvete, për arsye të mungesës së transparencës nga ky institucion. UShAF është i vetmi institucion publik i arsimit të lartë i cili nuk ka CV të stafit akademik të publikuar në ueb-faqe zyrtare. ORCA i është drejtuar UShAF me kërkesë për publikimin e CV-ve konform standardit të vendosur nga universitetet tjera publike. Kërkesa jonë nuk është shqyrtuar. Në vijim i jemi drejtuar Ministrisë së Arsimit, e cila financon drejtpërdrejt këtë institucion të arsimit të lartë, të cilët pavarësisht shqetësimit të tyre lidhur me transparencën e UShAF nuk kanë arritur të realizojnë kërkesën tonë.

Për këtë arsye, ORCA ka vendosur të hulumtojë publikimin shkencor të profesorëve të UShAF përmes platformave të tjera përmbledhëse të produktit shkencor, siç është Google Scholar.

Periudha hulumtuese për këtë raport është realizuar gjatë muajit tetor 2021, ku hulumtuesit e ORCA-s shqyrtuan materialet e publikuara në profilet e Google Scholar të stafit akademik të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj me titujt akademikë: profesor asistent, profesor i asocuar dhe profesor i rregullt.

Nga gjithsej 5 fakultete sa ka Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, janë shqyrtuar profilet e stafit akademik vetëm në 4 fakultete. Për arsye të natyrës specifike të tyre, ORCA nuk e ka bërë shqyrtimin e punimeve artistike të cilat kërkohen si kusht ekuivalent

i publikimeve shkencore për Fakultetin e Arteve të Aplikuara. Rrjedhimisht, profesorët e Fakultetit të Arteve të Aplikuara nuk janë pjesë e këtij raporti.

Nga gjetjet e përgjithshme del se në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj janë të punësuar 28 profesorë me tituj akademikë dhe kontratë të rregullt prej të cilëve 8 (28%) janë gra dhe 20 (72%) burra. 61% e stafit akademik nuk i justifikojnë titujt e tyre. Prej tyre, 36% janë gra dhe 64% janë burra.

Numri total i publikimeve në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj është 59. Fakulteti i Menaxhimit ka më së shumti publikime shkencore në revista shkencore, me gjithsej 18 të tilla dhe mesatare prej 2 punimesh për kokë profesori. Por, për shkak të numrit më të vogël të profesorëve në Fakultetin e Arkitekturës, Dizajnit, dhe Teknologjisë së Drurit (5 profesorë), mesatarja e punimeve për profesor është më e lartë me 3 punime për profesor.

Kjo analizë mund të shërbej për planifikimin dhe buxhetimin e politikave relevante që financojnë zhvillimin e projekteve shkencore brenda Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, në mënyrë që të rritet numri i publikimeve shkencore të mirëfillta në këtë universitet.

# TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

## BUXHETI

Nga thesari i buxhetit të Kosovës, për Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, ishin ndarë gjithsej 2 milionë e 295 mijë e 908 Euro për vitin 2020, ndërsa ishin shpenzuar 1 milionë e 745 mijë e 908 Euro. Kurse për vitin 2021, është ndarë apo planifikuar të shpenzohet shuma prej 1 milionë e 665 mijë e 908 Euro[1].

## STUDENTËT

Nga të dhënat zyrtare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës[2] rezulton se numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar në nivel Bachelor në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj për vitin akademik 2020/2021 është 1249 studentë, nga të cilët 739 janë vajza. Numri i të diplomuarve në nivel Bachelor gjatë vitit akademik 2019/2020 është 120, prej të cilëve 83 janë vajza. Sa i përket numrit të studenteve që janë duke studiuar në nivel Master në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj përgjatë vitit akademik 2020/2021, gjithsej janë 201 studentë, përkatësisht 109 janë vajza. Gjatë vitit 2019/2020, 8 studentë kanë diplomuar në nivelin master në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.

## TRANSPARENCA FORMALE

Nga hulumtimi i ORCA-s (vitit 2021) mbi transparencën dhe llogaridhënien në universitetet publike[3], del se Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj ka publikuar në uebfaqen zyrtare 15 nga gjithsej 27 dokumente apo informacione bazike rreth funksionimit të universitetit. Në vitin 2020[4], UShAF kishte 16 dokumente të publikuara, dhe në vitin 2019 kishte vetëm 8.[5]

1 Raporti "Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës: Menaxhimi i Financave 3", 2021, linku: http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2021/11/Menaxhimi-i-financave-3.pdf
2 Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e arsimit në Kosovë 2020/21, fq. 74, linku: https://ask.rks-gov.net/media/6292/statistikat-e-arsimit-n%C3%AB-kosov%C3%AB_2020-21.pdf
3 Raporti "Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës: (Mos)informimi i publikut 3", 2021, linku: http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2021/10/Mosinformimi-i-Publikut-3.pdf
4 Raporti "Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës: (Mos)informimi i publikut 2", 2020, linku: http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/Mosinformimi-i-Publikut-2.pdf
5 Raporti "Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës: (Mos)informimi i publikut", 2019, linku: http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/02-Transparenca-n%C3%AB-Universitetet-Publike-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-ALB-02.pdf

# PASQYRA AKADEMIKE E UNIVERSITETIT TË SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ


Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) ka 28 profesorë që janë evidentuar përmes listave të publikuara në uebfaqen e universitetit dhe gjithsej 4 fakultete (duke përjashtuar Fakultetin e Arteve të Aplikuara). Nga 28 profesorë sa ka në total, 8 janë gra (28%) dhe 20 janë burra (72%). Në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj janë 3 profesorë të rregullt, 2 profesorë janë të asocuar dhe 23 janë profesorë asistentë.

## NUMRI I PUBLIKIMEVE SHKENCORE NË UNIVERSITETIN E SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ

Profesorët e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj gjithsej kanë publikuar 59 punime shkencore. Kjo e dhënë është gjeneruar nga profilet e Google Scholar të profesorëve të listuar në uebfaqen e universitetit. Kurse numri i punimeve të vlefshme për avancim akademik është 42.

Në vitin 2020, profesorët e këtij universiteti kanë publikuar më së shumti punime shkencore, 16 apo 27% e totalit të punimeve shkencore.

## PUBLIKIMI SHKENCOR NË USHAF




Fakulteti i Menaxhimit evidentohet si fakulteti me më së shumti publikime shkencore në revista shkencore, me gjithsej 18 të tilla dhe mesatare prej 2 punimesh për kokë profesori. Por, për shkak të numrit më të vogël të profesorëve në Fakultetin e Arkitekturës, Dizajnit, dhe Teknologjisë së Drurit (5 profesorë), mesatarja e punimeve për profesor është më e lartë me 3 punime për profesor.

Ndërkohë që fakulteti me më së paku punime të botuara në revista shkencore në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj  është Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës me 12 punime dhe mesatare prej 1.71 punime për kokë profesori.

## PUBLIKIMET SHKENCORE PËR PROFESOR


| Nr. | Fakultetet në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj | Numri total i publikimeve | Numri total i profesorëve | Punime për profesor |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit, dhe Teknologjisë së Drurit | 15 | 5 | 3.00 |
| 2 | Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës | 12 | 7 | 1.71 |
| 3 | Fakulteti i Menaxhimit | 18 | 9 | 2.00 |
| 4 | Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit | 14 | 7 | 2.00 |
| | **TOTAL** | 59 | 28 | 2.11 |

Mesatarja e punimeve në nivel universiteti është 2.11 punime për profesor.

Për krahasim, në të dhënat e mbledhura nga viti 2020, në Universitetin e Gjilanit janë 1.53 punime për profesor, në Universitetin e Gjakovës janë 3.65 punime për profesor, në Universitetin e Mitrovicës janë 3.61 punime për profesor, ndërsa në Universitetin e Prishtinës mesatarja është 5 punime për profesor.

Nga të dhënat e mbledhura nga viti 2019, në Universitetin e Prizrenit ishin 1.17 punime për profesor. Ndërsa në Universitetin e Pejës numri i punimeve shkencore për kokë profesori ishte 0.70.


## MESATARJA E PUNIMEVE PËR PROFESOR NË TË GJITHA UNIVERSITETET PUBLIKE




Të dhënat e gjeneruara nga hulumtimi, tregojnë se nga 28 profesorë sa ka Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, 16 apo 57% nuk kanë të botuar asnjë punim shkencor në revista shkencor, si autor i parë ose korrespondent.

Është e rëndësishme të theksohet që në të dhënat e mbledhura gjatë vitit 2020 numri i profesorëve që nuk kanë publikuar asnjë punim shkencor në Universitetin e Mitrovicës është 23 apo 32%, në Universitetin e Gjilanit 21 apo 53%, në Universitetin e Gjakovës 14 apo 54%, ndërsa në Universitetin e Prishtinës 150 apo 29%. Ndërkohë që nga të dhënat e vitit 2019, në Universitetin e Prizrenit ishin 31 apo 55% dhe në Universitetin e Pejës ishin 22 apo 66% profesorë që nuk kanë asnjë punim shkencor.

## PËRQINDJA E PROFESORËVE PA ASNJË PUNIM NË TË GJITHA UNIVERSITETET PUBLIKE




Fakulteti me më së shumti profesorë që nuk kanë të botuar asnjë punim, është Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit, ku 71% e profesorëve nuk kanë asnjë punim shkencor. Që të gjitha fakultetet e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj kanë raste me profesorë pa asnjë punim shkencor, mirëpo mesatarja më e ulët e rasteve të tilla shënohet në Fakultetin e Menaxhimit me 44% apo 4 profesorë.

| Nr | Fakultetet në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj | Numri i profesorëve pa asnjë punim shkencor | Numri total i profesoreve |
|---|---|---|---|
| 1 | Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit, dhe Teknologjisë së Drurit | 3 (60%) | 5 |
| 2 | Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës | 4 (57%) | 7 |
| 3 | Fakulteti i Menaxhimit | 4 (44%) | 9 |
| 4 | Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit | 5 (71%) | 7 |
| | **TOTAL** | 16 (57%) | 28 |

# PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA

Nga gjithsej 28 profesorë të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, 11 apo 39% kanë publikuar në revista të dyshimta. Numri i përgjithshëm i punimeve të tilla në nivel universiteti është 23. Fakulteti me më së shumti botime në revista të dyshimta cilësohet të jetë Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit, dhe Teknologjisë së Drurit me gjithsej 10 punime.


PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA

| Nr. | Fakultetet në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj | Numri i publikimeve në revista të dyshimta | Numri i profesorëve që publikuan në revista të dyshimta |
|---|---|---|---|
| 1 | Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit, dhe Teknologjisë së Drurit | 10 | 2 |
| 2 | Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës | 4 | 2 |
| 3 | Fakulteti i Menaxhimit | 7 | 5 |
| 4 | Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit | 2 | 2 |
| | **TOTAL** | 23 | 11 |


Për krahasim, nga numri total i profesorëve, publikimi në revista të dyshimta në Universitetin e Gjilanit nga të dhënat e vitit 2021 është 35%, , ndërsa nga të dhënat e vitit 2020, në Universitetin e Prishtinës është 38%, në Universitetin e Gjakovës është 58%, përderisa në Universitetin e Mitrovicës përqindja e publikuesve është dukshëm më e lartë, më përkatësisht 78%.

Ndërkaq nga të dhënat e vitit 2019, në Universitetin e Pejës 45% e profesorëve kanë publikuar në revista të dyshimta, kurse në Universitetin e Prizrenit kjo e dhënë ishte 66%.

## PËRQINDJA E PROFESORËVE QË KANË BOTUAR NË REVISTA TË DYSHIMTA NË TË GJITHA UNIVERSITETET PUBLIK




Profesorët e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj kanë publikuar në revista të dyshimta brenda një periudhe 10 vjeçare, më konkretisht nga viti 2011 deri në vitin 2020. Viti 2013 karakterizohet si viti me më së shumti publikime në revista të dyshimta, në total 7. Ndërkaq në vitet në vazhdim, numri i publikimeve në revista të dyshimta ka pësuar rënie, me 2 punime në vitin 2020 dhe 0 në 2021.



PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA - USHAF
8
7
6
5
4
3
2
1
0
1
1
7
0
4
2
3
0
3
2
0
2011
2012
2013
2014
2015
2016
2017
2018
2019
2020
2021

# JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Nga 28 profesorë në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, 17 apo 61% nuk i justifikojnë titujt akademikë sipas kriterit të punimeve shkencore si autor i parë dhe korrespondent. Për krahasim, nga të dhënat e vitit 2021, 65% e profesorëve në Universitetin e Gjilanit nuk i justifikonin titujt e tyre akademikë, ndërsa nga të dhënat e vitit 2020, në Universitetin e Prishtinës 45% e profesorëve nuk i justifikojnë titujt e tyre, 65% e profesorëve të Universitetit të Gjakovës nuk i justifikojnë tituj akademikë, dhe mosjustifikimi i titujve akademikë në Universitetin e Mitrovicës ishte 48%.


Të dhënat e vitit 2019, tregojnë se 64% e profesorëve në Universitetin e Prizrenit nuk i justifikojnë titujt akademikë,  dhe në Universitetin e Pejës mosjustifikimi i titujve nga stafi i rregullt akademikë ishte 70%.

## PËRQINDJA E PROFESORËVE QË NUK JUSTIFIKOJNË TITUJT AKADEMIKË NË TË GJITHA UNIVERSITETET PUBLIKE



Nga 23 profesorë asistentë, 13 apo 57% prej tyre nuk i justifikojnë titujt akademikë, përderisa asnjëri nga 2 (100%) profesorët e asocuar nuk i justifikojnë titujt akademikë. Nga 3 profesorë të rregullt, 2 apo 67% nuk justifikojnë titujt e tyre akademikë.

## JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË NË USHAF




Fakultetet me më së shumti profesorë që nuk i justifikojnë titujt e tyre akademikë janë Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës, si dhe Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit, ku në të dy fakultetet 71% e profesorëve nuk i justifikojnë titujt.

Kurse fakulteti ku justifikohen më së shumti titujt është Fakulteti i Menaxhimit me 44%.

| Nr. | Fakultetet në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj | Pozitiv | Negativ | TOTAL |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit, dhe Teknologjisë së Drurit | 2 (40%) | 3 (60%) | 5 |
| 2 | Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës | 2 (29%) | 5 (71%) | 7 |
| 3 | Fakulteti i Menaxhimit | 5 (56%) | 4 (44%) | 9 |
| 4 | Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit | 2 (29%) | 5 (71%) | 7 |
| | TOTAL | 11 (39%) | 17 (61%) | 28 |

Në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, përqindja e mosjustifikimit është më e lartë te profesorët e asocuar se sa te profesorët asistent. Sa më i lartë titulli akademik, aq më shumë rriten gjasat për të mos justifikuar titujt akademik. Përjashtimisht, një profesor i rregullt e justifikon titullin e tij.






















| Nr. | Fakultetet në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj | Profesorë të rregullt | | Profesorë të asocuar | | Profesorë asistentë | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Justifikojnë | Nuk justifikojnë | Justifikojnë | Nuk justifikojnë | Justifikojnë | Nuk justifikojnë |
| 1 | Fakulteti i Arkitekturës, Dizajnit, dhe Teknologjisë së Drurit | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 3 |
| 2 | Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës | 0 | 2 | 0 | 1 | 2 | 2 |
| 3 | Fakulteti i Menaxhimit | 0 | 0 | 0 | 1 | 5 | 3 |
| 4 | Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 5 |
| | TOTAL | 1 (33%) | 2 (67%) | 0 (0%) | 2 (100%) | 10 (43%) | 13 (57%) |

# KRAHASIMI ME UNIVERSITETET E TJERA PUBLIKE

Nga të dhënat e vitit 2021, 57% e profesorëve në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj nuk kanë asnjë punim shkencor. Po ashtu nga të dhënat e vitit 2021, 53% e profesorëve në Universitetin e Gjilanit nuk kanë asnjë punim shkencor. Nga të dhënat e vitit 2020, përqindja e profesorëve pa asnjë punim në Universitetin e Mitrovicës është 32%, në Universitetin e Gjakovës 54%, dhe në Universitetin e Prishtinës është 29%, njëherit përqindja më e ulët në këtë kategori statistikore ndër të gjitha universitetet publike. Ndërkohë nga të dhënat e vitit 2019, në Universitetin e Prizrenit 55% e profesorëve nuk kanë asnjë punim shkencor, si dhe 66% e profesorëve të Universitetit të Pejës nuk kanë botuar asnjë punim shkencor.

Nga të dhënat e vitit 2021, 61% e profesorëve në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj nuk justifikojnë titujt e tyre akademikë. Po ashtu nga të dhënat e vitit 2021, 65% e profesorëve në Universitetin e Gjilanit nuk justifikojnë titujt e tyre akademikë. Ndërsa të dhënat nga viti 2020 tregojnë se, përqindja e mosjustifikimit të titujve akademikë në në Universitetin e Mitrovicës është 48%, në Universitetin e Gjakovës është 65%, përderisa në Universitetin e Prishtinës është 45%, që rezulton të jetë mosjustifikimi i titujve akademikë më i ulët ndër universitetet publike në vend. Nga të dhënat e vitit 2019 del se, 64% e profesorëve në Universitetin e Prizrenit nuk i justifikojnë titujt akademikë, përderisa për të njëjtën periudhë mosjustifikimi i titujve në Universitetin e Pejës është 70%.

Nga të dhënat e vitit 2021, 39% e profesorëve në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj kanë publikime në revista të dyshimta. Po ashtu nga të dhënat e vitit vitin 2021, 35% e profesorëve në Universitetin e Gjilanit rezultojnë të kenë publikuar në revista të dyshimta. Sa i përket përqindjes së profesorëve që kanë publikuar në revista të dyshimta për vitin 2020 në Universitetin e Mitrovicës është 78%, ndërkohë që në Universitetin e Prishtinës është 38%, si dhe në Universitetin e Gjakovës është 58%. Nga të dhënat e vitit 2019, në Universitetin e Prizrenit 66% e profesorëve kanë publikuar në revista të dyshimta, si dhe në Universitetin e Pejës 45% e profesorëve kanë publikuar në revista të dyshimta.

| Universiteti | Përqindja e profesorëve pa asnjë punim | Përqindja e mosjustifikimit të titujve | Përqindja e profesorëve që kanë publikuar në revista të dyshimta |
|---|---|---|---|
| Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj* |  |  |  |
| Universiteti i Gjilanit* |  |  |  |
| Universiteti i Mitrovicës** |  |  |  |
| Universiteti i Prishtinës** |  |  |  |
| Universiteti i Gjakovës** |  |  |  |
| Universiteti i Prizrenit*** |  |  |  |
| Universiteti i Pejës*** |  |  |  |

Sqarim i fusnotave:

* Të dhënat nga viti 2021

** Të dhënat nga viti 2020

*** Të dhënat nga viti 2019


# FAKULTETI I ARKITEKTURËS, DIZAJNIT, DHE TEKNOLOGJISË SË DRURIT

**5** profesorë me tituj akademikë
**1** profesor i rregullt
**Asnjë (0)** profesor i asocuar
**4** profesorë asistentë

## PUBLIKIMI SHKENCOR


Profesorët  e Fakultetit të Arkitekturës, Dizajnit, dhe Teknologjisë së Drurit gjithsej kanë publikuar 15 punime në revista shkencore, prej të cilave 7 janë të vlefshme për avancim akademik, që nënkupton si autor i parë dhe korrespondent. 3 profesorë nga ky fakultet nuk kanë asnjë punim të publikuar si autor i parë ose korrespondent.

### PUBLIKIMI SHKENCOR NË FAKULTETIN E ARKITEKTURËS, DIZAJNIT DHE TEKNOLOGJISË SË DRURIT



Nga ky fakultet 2 profesorë kanë publikuar në revista të dyshimta me gjithsej 10 punime, ku vetëm në vitin 2013 janë botuar 5 punime të tilla. Nga viti 2017 nuk ka botime në revista të dyshimta.

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA - FAKULTETI I ARKITEKTURËS, DIZAJNIT DHE TEKNOLOGJISË SË DRURIT




# JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Nga 5 profesorë, 3 apo 60% prej tyre nuk i justifikojnë titujt akademikë, sa i përket kritereve ligjore për publikime në revista shkencore si autor i parë ose korrespondent.
Ky fakultet ka vetëm 1 profesor të rregullt, që justifikon titullin akademik. Nuk ka asnjë profesor të asocuar. Kurse nga gjithsej 4 profesorë asistentë, vetëm njëri justifikon titullin akademik.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE

| **Profesorë asistentë** | | **Profesorët e asocuar** | | **Profesorët e rregullt** | | **Total** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Justifikojnë | Nuk justifikojnë | Justifikojnë | Nuk justifikojnë | Justifikojnë | Nuk justifikojnë | Justifikojnë | Nuk justifikojnë |
| 1 | 3 | 0 | 0 | 1 | 0 | 2 (40%) | 3 (60%) |


# FAKULTETI I INXHINIERISË DHE INFORMATIKËS

**7** profesorë me tituj akademikë
**2** profesor i rregullt
**1** profesorë të asocuar
**4** profesorë asistentë

## PUBLIKIMI SHKENCOR


Profesorët në Fakultetin e Inxhinierisë dhe Informatikës kanë publikuar në total 12 punime në revista shkencore. Kurse të vlefshme për avancim akademik janë 11, pra si autor i parë ose korrespondent. 4 profesorë në këtë fakultet nuk kanë asnjë punim të publikuar si autor i parë apo korrespondent.

PUBLIKIMI SHKENCOR NË FAKULTETIN E INXHINIERISË DHE INFORMATIKËS



2 profesorë kanë publikuar në revista të dyshimta, një profesor i rregullt dhe një profesor asistent. Numri total i punimeve te botuara në revista të dyshimta është 4. Nga viti 2018 nuk ka pasur më botime në revista të dyshimta.

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA -
FAKULTETI I INXHINIERISË DHE INFORMATIKËS




# JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Nga 7 profesorë të Fakultetit të Inxhinierisë dhe Informatikës, 5 apo 71% prej tyre nuk i justifikojnë titujt akademikë siç përcaktohet në bazë të kritereve për publikime në revista shkencore si autori i parë ose korrespondent. 2 profesorët e rregullt nuk justifikojnë titujt e tyre akademikë. I vetmi profesor i asocuar nuk justifikon titullin e tij akademik. Nga 4 profesorët asistent, 2 nuk justifikojnë titujt e tyre akademikë.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE

| **Profesorë asistentë** | | **Profesorët e asocuar** | | **Profesorët e rregullt** | | **Total** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Justifikojnë | Nuk justifikojnë | Justifikojnë | Nuk justifikojnë | Justifikojnë | Nuk justifikojnë | Justifikojnë | Nuk justifikojnë |
| 2 | 2 | 0 | 1 | 0 | 2 | 2 (29%) | 5 (71%) |


# FAKULTETI I MENAXHIMIT

**9** profesorë me tituj akademikë
**Asnjë (0)** profesor i rregullt
**1** profesorë të asocuar
**8** profesorë asistentë

# PUBLIKIMI SHKENCOR


Në Fakultetin e Menaxhimit, stafi i rregullt akademik kanë publikuar gjithsej 18 punime në revista shkencore. Kurse të vlefshme për avancim akademik janë 14, pra si autor i parë ose korrespondent. 4 profesorë në këtë fakultet nuk kanë asnjë punim të publikuar si autor i parë apo korrespondent.

PUBLIKIMI SHKENCOR NË FAKULTETIN E MENAXHIMIT



5 profesorë kanë publikuar 7 herë në revista të dyshimta. Në vitin 2021 nuk ka asnjë punim në revista të dyshimta.

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA - FAKULTETI I MENAXHIMIT




# JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Prej 9 profesorëve, 4 apo 44% nuk i justifikojnë titujt akademikë, në bazë të kritereve të parapara për publikime në revista shkencore si autor i parë dhe korrespondent.
Nuk ka profesorë të rregullt në këtë fakultet. I vetmi profesor i asocuar nuk justifikon titullin e tij. Nga 8 profesorët asistentë, 3 nuk justifikojnë titujt e tyre.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE

| **Profesorë asistentë** | | **Profesorët e asocuar** | | **Profesorët e rregullt** | | **Total** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Justifikojnë | Nuk justifikojnë | Justifikojnë | Nuk justifikojnë | Justifikojnë | Nuk justifikojnë | Justifikojnë | Nuk justifikojnë |
| 5 | 3 | 0 | 1 | n/a | n/a | 5 (56%) | 4 (44%) |


# FAKULTETI I TURIZMIT DHE AMBIENTIT

**7** profesorë me tituj akademikë
**Asnjë (0)** profesor i rregullt
**Asnjë (0)** profesorë të asocuar
**7** profesorë asistentë

## PUBLIKIMI SHKENCOR


Në Fakultetin e Turizmit dhe Ambientit, gjithsej 7 profesorë kanë publikuar 14 punime shkencore, prej të cilave 10 janë të vlefshme për avancim akademik, pra si autor i parë dhe korrespondent. Nga 7 profesorët, 5 nuk kanë asnjë punim shkencor si autor i parë ose korrespondent.

PUBLIKIMI SHKENCOR NË FAKULTETIN E TURIZMIT DHE AMBIENTIT



2 profesorë kanë botuar në revista të dyshimta me gjithsej 2 punime. Punimi i fundit në revista të dyshimta është në vitin 2019.

PUBLIKIMI NË REVISTA TË DYSHIMTA - FAKULTETI I TURIZMIT DHE AMBIENTIT




# JUSTIFIKIMI I TITUJVE AKADEMIKË

Nga 7 profesorë, 5 apo 71% nuk i justifikojnë titujt akademikë, në bazë të kritereve të para-para për publikime në revista shkencore si autor i parë dhe korrespondent.
Nuk ka profesorë të rregullt ose profesorë të asocuar në këtë fakultet. Nga 7 profesorët asistentë, 5 nuk i justifikojnë titujt e tyre akademikë.

JUSTIFIKIMI I TITUJVE

| **Profesorë asistentë** | | **Profesorët e asocuar** | | **Profesorët e rregullt** | | **Total** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Justifikojnë | Nuk justifikojnë | Justifikojnë | Nuk justifikojnë | Justifikojnë | Nuk justifikojnë | Justifikojnë | Nuk justifikojnë |
| 2 | 5 | n/a | n/a | n/a | n/a | 2 (29%) | 5 (71%) |

# METODOLOGJIA

## BAZA LIGJORE

1. Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës[6]
2. Statuti i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, gjegjësisht Nenet 157, 158, 159[7]
3. Udhëzimi Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension[8]
4. Udhëzimi Administrativ për plotësimin dhe precizimin – (Aneksi –I- MASHT) 7/2018 e Udhëzimit Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension.[9]

ORCA ka bërë shqyrtimin e publikimeve në revista shkencore ndërkombëtare, të përcaktuara si kriter nga Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë, Statutin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj për zgjedhje në njërin nga titujt akademikë: profesor asistent, profesor i asocuar apo profesor i rregullt, Udhëzimet Administrative 01/2018 dhe 07/2018.

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj nuk ka (ose nuk e ka të publikuar) rregullore për emërimin, riemërimin, dhe përzgjedhjen e stafit akademik.

6 Ligji për arsimin e lartë, 2011, linku: https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2761
7 Statuti i Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, 2020, linku: https://ëëë.ushaf.net/wp-content/uploads/2021/07/STATUTI_I_UNIVERSITETIT_TE_SHKENCAVE_TE_APLIKUARA_NE_FERIZAJ.pdf
8 Udhëzimi Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, 2018, linku: http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/01/ua-nr-01-2018-parimet-e-njohjes-se-platoformave-dhe-revistave-nderkombetare-me-recension.pdf
9 Udhëzimi Administrativ për plotësimin dhe precizimin – (Aneksi –I- MASHT) 7/2018 e Udhëzimit Administrativ 01/2018 Parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension, 2018, linku: http://masht.rks-gov.net/uploads/2018/05/ua-7-2018-per-plotesimin-dhe-precizimin-e-ua-parimet-e-njohjes-per-revistat-nderkombetare_1.pdf

# OBJEKTI I SHQYRTIMIT

Për realizimin e këtij hulumtimi, ORCA në universitete tjera publike është bazuar në CV-të e publikuara në uebfaqet zyrtare të universiteteve. Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj nuk ka CV të publikuara për asnjë nga profesorët, përtej rektorit të universitetit. UShAF po ashtu ka refuzuar të i përgjigjet kërkesës tonë për publikim të CV-ve ose të na ofrojë qasje në to.

Për nevoja të këtij hulumtimi, ORCA është bazuar në profilet publike të profesorëve në platformën Google Scholar.

Janë shqyrtuar profilet e 28 anëtarëve të stafit profesorial në 4 fakultete të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj. Këtu nuk përfshihen asistentët, ligjëruesit, lektorët dhe bashkëpunëtorët e tjerë të cilët nuk i kanë titujt akademikë profesor asistent, profesor i asocuar apo profesor i rregullt.

Për arsye të natyrës specifike të tyre, ORCA nuk e ka bërë shqyrtimin e punimeve artistike të cilat kërkohen si kusht ekuivalent i publikimeve shkencore për profesorë nga lëmia e artit. Rrjedhimisht, profesorët e Fakultetit të Arteve të Aplikuara nuk janë pjesë e këtij raporti.

# PERIUDHA E MBLEDHJES SË MATERIALIT PËR HULUMTIM

Për realizimin e këtij hulumtimi, ORCA në universitete tjera publike është bazuar në CV-të e publikuara në uebfaqet zyrtare të universiteteve. Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj nuk ka CV të publikuara për asnjë nga profesorët, përtej rektorit të universitetit. UShAF po ashtu ka refuzuar të i përgjigjet kërkesës tonë për publikim të CV-ve ose të na ofrojë qasje në to.

Për nevoja të këtij hulumtimi, ORCA është bazuar në profilet publike të profesorëve në platformën Google Scholar. Hulumtimi është realizuar gjatë muajit tetor 2021, dhe është rishikuar dhe rivlerësuar nga stafi hulumtues i ORCA-s gjatë muajit dhjetor 2021.

# LLOGARITJA E JUSTIFIKIMIT TË TITUJVE AKADEMIK

Sikurse të gjitha universitetet publike në Kosovë, dhe në bazë të legjislacionit në fuqi, në procesin e avancimit vlen autorësia e parë si dhe korrespondenca në një punim shkencor.

Për pozitën profesor asistent, kandidatët duhet të kenë të publikuar të paktën një punim shkencor në revista shkencore ndërkombëtare me recension, sipas legjislacionit në Kosovë, si autor të parë ose korrespondent. Rrjedhimisht, sipas rregullativave aktuale, koeficientin e publikimeve duhet ta kenë 1.

Për pozitën profesor të asocuar kandidatët duhet të kenë të publikuar të paktën tri punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare, sipas legjislacionit në Kosovë, si autor të parë ose korrespondent. Rrjedhimisht, sipas rregullativave aktuale, koeficientin e publikimeve duhet ta kenë 3.

Për pozitën profesor të rregullt, kandidatët duhet të kenë të publikuar të paktën pesë punime shkencore në revista shkencore ndërkombëtare relevante, sipas legjislacionit në Kosovë, si autor të parë ose korrespondent. Rrjedhimisht, sipas rregullativave aktuale, koeficientin e publikimeve duhet ta kenë 5.

Duke u bazuar në UA1/2018, UA7/2018, ORCA ka vendosur koeficiente për secilin punim. Këto koeficiente janë vendosur përkatësisht sipas databazave ku janë të indeksuara revistat me koeficientet 1, 0.85 apo 0.70.

ORCA i ka barasvlerësuar me koeficient 0 punimet e publikuara në përmbledhje konferencash, raportet, projektet, librat apo kapituj librash të cilat nuk janë revista shkencore ndërkombëtare, si dhe punimet të cilat janë në proces të publikimit, apo punimet për të cilat autorët kanë marrë çfarëdo konfirmimi nga revista përkatëse, por që nuk janë publikuar.

Publikimet në revista shkencore vendore dhe të vendeve fqinje, bazuar në Udhëzimin Administrativ për parimet e njohjes së platformave dhe revistave ndërkombëtare me recension janë barasvlerësuar me koeficient 0.

Publikimet në revista të listuara si të dyshimta apo që botuesin e kanë të listuar si të dyshimtë janë barasvlerësuar me koeficient 0 dhe janë numëruar për nevoja të këtij hulumtimi.

# LLOGARITJA E NUMRIT TË PUBLIKIMEVE SHKENCORE

Pas hulumtimit të CV-ve, publikimet shkencore të gjetura në revista sipas rregullativave të përmendura, janë krahasuar mes secilit profesor brenda fakultetit, për të eliminuar dyfishimin e tyre.

Në këtë numër janë përfshirë të gjitha punimet shkencore të botuara në revista shkencore, si dhe nga analiza e justifikimit të titujve ku janë llogaritur vetëm publikimet në të cilat profesorët e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj figurojnë si autorë të parë dhe korrespondent.

DEKLARATË E MOHIMIT TË PËRGJEGJËSISË:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim në kuadër të projektit "Cilësi, Llogaridhënie, Integritet dhe Transparencë në Arsimin e Lartë – QAINT". Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

With funding from

Austrian Development Cooperation

*Republika e Kosovës*
*Republika Kosova -Republic of Kosovo*
*Qeveria – Vlada - Government*

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë*
*Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju*
*Ministry of Education, Science and Technology*

KEC Qendra për Arsim e Kosovës Kosova Education Center

ORCA organizata për rritjen e cilësisë në arsim

ZSI Centre for Social Innovation